



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:024394  
Datë: 01.02.2024  
Numri i dokumentit: 05269731

2023:024395

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.T. nga fshati .... - Komuna Ferizaj, me numër personal ..., të cilin e përfaqëson av. Liman Musa nga Ferizaj kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve S., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit të pacaktuar, pas shqyrtimit të parashtrësës së datës 29.01.2024 për tërheqjen e padisë, me datë 01.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Konstatohet se është tërhequr padia me shenjën 2023:024395 e paditëses M.T. nga fshati ...- Komuna Ferizaj, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve S., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit të pacaktuar.

**A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij av. Liman Musa nga Ferizaj, ka ushtruar padi në këtë gjykatë më dt. 26.01.2023 kundër të paditurit, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit të pacaktuar.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me parashtrësën e datës 29.01.2024, e ka njoftuar gjykatën se me të paditurin kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, prandaj i kërkojnë gjykatës që të merr aktvendim për tërheqjen e padisë. Meqë në gjykatë nuk ka mbërritur përgjigja në padi e të paditurit, gjykata nuk ia dërgoi parashtrësën e paditësit për deklarim të njëjtit.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 01.02.2024

Gjyqtari  
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.